

VENDIM
Nr. 414, datë 4.7.2018

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT
“NDËRTIMI I NËNSTACIONIT TË RI 110/20 kV”, VELIPOJË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1; 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 109/2017, “Për buxhetin e vitit 2018”, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Ndërtimi i nënstacionit të ri 110/20 kV”, Velipojë.
2. Shpronësimi bëhet në favor të Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE) sh.a
3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, në shumën totale prej 972 000 (nëntëqind e shtatëdhjetë e dy mijë) lekësh.
4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 972 000 (nëntëqind e shtatëdhjetë e dy mijë) lekësh, të përballohet nga Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE) sh.a., si subjekti kërkues i këtij shpronësimi.
5. Shpenzimet procedurale, në vlerën prej 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekësh, të përballohen nga Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE) sh.a.
6. Shpronësimi të fillojë pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
7. Pronarët e pasurive të paluajtshme, të përmendur në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim, pranë Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE) sh.a.
8. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Shkodër, brenda 30 ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Operatorin e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE) sh.a., të fillojnë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale të regjistrimit, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe të bëjnë kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të OSHEE sh.a.
9. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Shkodër të pezullojnë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara, deri në momentin kur do të realizohet procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale të regjistrimit.
10. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE) sh.a., dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Shkodër për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

“NDËRTIMI I NËNSTACIONIT NË VËLIPOJË 110/20 kV”

INVESTITORI: OSHEE SHA

Çmimi për pasurinë truall, sipas vendimit nr. 89, datë 3.2.2016.

[illegible]